



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 3501 Prot

Vlorë, më 26 / 12 /2017

VENDIM

Nr. 37, datë 20 / 12 /2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË QARKUT VLORË NR. 23,
DATË 20.07.2017 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURAVE PËR
DHËNIEN E “TITUJVE VENDORË TË NDERIT”,**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë / /2017 në zbatim të nenit 77, pika II të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit Nr.112/2014 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë” si dhe Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 23, datë 20.07.2017 për miratimin e rregullores së procedurave për dhënien e “Titujve Vendorë të Nderit”,

VENDOSI;

1.Ndryshimin e pikës “c” të Nenit 2 “Titujt e Nderit“ në Rregulloren mbi procedurat e dhënies së “Titujve Vendor të Nderit“, miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë Nr. 23, datë 20.07.2017.

2.Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Këshillit të Qarkut, Komisioni Këshillimor, Drejtori i Kabinetit si dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ervis Moçka